Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ardian Behra	**12.09.2024**	**27.09.2024**	**2024/0792**
Eksperti Teknik **Kreshnik Spahiu**	Data e autorizimit të ekspertit teknik **16.09.2024**		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 04.09.2024, OE “"LOGISTICS PLUS"L.L.C.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0792, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Zhvillimi dhe implementimi i sistemit e-Kabineti” me nr. të prokurimit: "214-24-8329-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur? t? hapur, lloji i kontrat?, sh?rbim, vlera e parashikuar e kontrat?s: 90,000.00€.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2024/0792 i dt:04.09.2024.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

1. Nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik,

2. Nenin 109 të Ligjit për Prokurim Publik,

3. Nenin 7 të Ligjit për Prokurim Publik,

4. Paragrafin 3.c të nenit 4 RRPP,

5. Opinioni Ligjor të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (nr. 1731/23, dt.19/09/2023),

6. Nenin 28 të Ligjit për Prokurim Publik

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*:
a. Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Nenin 65 të Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L068 dhe ligjin Nr. 05 L-092.	**a. Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit, Aneksi 2 (Origjinal).**
b. Një dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë	**b. Vërtetimin nga Administrata Tatimore (kopje), duhet të dorëzohen vetëm ngatenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të Vërtetimit nga administrata tatimore, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do te konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar**
c. Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit, që vërteton se tenderuesi i përmbush "Kërkesat e pranueshmërisë", i cili	**c. Çertifikatë nga Gjykata ThemeloreDepartamenti për Çështje Ekonomike apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të operatorit ekonomik (kërkohet origjinal ose i vërtetuar noterizuar nga institucioni**

dokument duhet të jetë jo me i vjetër se 3 muaj para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.	**kompetent në vendin tuaj të themelimit), duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të Çërtifikatës nga Gjykata perkatëse, tenderi i tij do të refuzohet si dhe do te konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar, AK do të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Tenderuesin qe është listuar në vendin e dytë.**	
d. Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit, që vërteton se tenderuesi i përmbush "Kërkesat e pranueshmërisë", se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile, i cili dokument duhet të jetë jo me i vjetër se 3 muaj para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.	**d. Çertifikatë nga Gjykata kompetente- (kërkohet origjinal ose i vërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit), duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të Çërtifikatës nga Gjykata perkatëse, tenderi i tij do të refuzohet si dhe do te konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar, AK do të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Tenderuesin qe është listuar në vendin e dytë.**	
Profesionalna podobnost	*Dështmia e kërkuar dokumentare:*	
a.Certifikatë e regjistrimit të biznesit, regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin tuaj të themelimit me Informata mbi biznesin dhe veprimtaritë. Për Operatorin Ekonomik jo rezident ne Kosove, nëse shpërblehet me kontratë, para nënshkrimit te kontratës,	**a. Certifikatë e regjistrimit të biznesit, me informata dhe veprimtaritë e biznesit (kopje).**	

është i obliguar qe ta regjistrojnë përfaqësinë e biznesit ne Republikën e Kosovës	
b. Deklarues i TVSH-së, (për kompanitë vendore).	**b. Certifikata e TVSH-së (kopje).**
Ekonomski i finansijski kapacitet	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
a. Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit kontraktues se qarkullimi vjetor (të hyrat) e OE-së për periudhën e shkuar trevjeçare (2021,2022,2023) ka qenë jo më pak se 150,000.00€.	**a. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës (ose në vendin e themelimit të OE-së) për periudhën e shkuar trevjeçare.**
Tehnicke i profesionalne mogucnosti	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1. Menaxheri i projektit duhet të jetë inxhinier i diplomuar i shkencave kompjuterike ose Master i inxhinierisë ose shkencave kompjuterike, menaxhment informatike ose biznes dhe menaxhment dhe duhet te kete se paku njërën nga këto certifikatat PMP, PMI, ITIL, ScrumMaster, CAPM, IPMA, PRINCE2, CPM – dhe te kete min. 5 vite përvojë pune dhe të ketë menaxhuar të paktën një (1) projekte të ngjashme sipas kërkesave të projektit.	**1. Diploma përkatëse , CV,Certifikat perkatese kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi – (origjinal) Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit– (kopje), Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara.**
2. Arkitek i softuerit - (1 Zyrtar), duhet të jetë inxhinier i diplomuar i shkencave kompjuterike ose Master i shkencave kompjuterike, Master inxhinierisë kompjuterik, min. 3 vite përvojë pune pas diplomimit si arkitekt i projekteve softuerike të natyrës së ngjashme dhe të jete pjesëmarrës në së paku një (1) projekte te ngjajshem.	**2. Diploma përkatëse , CV, kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit– (kopje), Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara.**

3. Zhvillues fullstack të Softuerit (Programer) – (3 Zyrtar), duhet të jetë i Inxhinier i diplomuar i shkencave kompjuterike , Baçelor i shkencave ose Baçelor inxhinierisë kompjuterike , min. 3 vite përvojë pune pas diplomimit si zhvillimin e softuerit (programim) të projekteve të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET), PHP, NodeJs, ose e ngjashme, dhe të jete pjesëmarrës në së paku një (1) projekte në zhvillimin e softuerit.	**3. Diploma përkatëse , CV, kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit– (kopje), Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara.**	
4. Operatori ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomikë duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses se paku nje projekte në lëminë e shërbimeve të ngjashme, në vlerë prej të gjitha së bashku jo më pak se 100,000.00 €, të realizuar në tri vjetët e shkuara, para datës së publikimit të këtij njoftimi për kontratë.	**4.Lista e projekteve të përfunduara Origjinal e vulosur dhe e nënshkruar nga OE për projekte e realizuara, duke bashkëngjitur referenca ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të sherbimeve duke treguar vlerën, datën dhe vendin e realizimit të projektit.**	

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

N/A

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **"LOGISTICS PLUS"L.L.C.**

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Ministria e Punëve të Brendshme (AK), në aktivitetin e prokurimit me emër 'Zhvillimi dhe implementimi i sistemit e-Kabineti' dhe me numër '214-24-8329-2-2-1, bën shkelje të dispozitave ligjore si në vijim:

a. Neni 108/A, paragrafi 12 i Ligjit për Prokurim Publik (këtu e tutje: LPP)

b. Neni 109, paragrafi 2 i LPP-së

c. Neni 7 i LPP-së

d. Neni 28 i LPP-së

e. Neni 4, paragrafi 3, nënparagrafi c) i Rregullores për Prokurim Publik (këtu e tutje:RRPP)

f. Opinionin Ligjor të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (nr. 1731/23, dt.19/09/2023)

g. Neni 97, paragrafi 1, nënparagrafët d), e) dhe p i RRPP

1. Pretendimi ankimor i parë (1) në Kërkesën për Rishqyrtim ishte ky si në vijim:

Citat

"Autoriteti Kontraktues, me kërkesat për listën e të punësuarve, duke përfshirë kualifikimet profesionale të stafit kryesor, ka shkelur Nenin 7 të Ligjit për Prokurim Publik, duke favorizuar një Operator Ekonomik (OE) të cilit i janë përshtatur kërkesat për staf, duke filluar nga emërtimi i drejtimeve, pa mundësuar drejtime ekuivalente dhe përvojën e punës sipas stafit që kompania e favorizuar posedon. Këto kërkesa, përveç favorizimit të një OE, e reduktojnë konkurrencën. Të dyja këto veprime janë të ndaluara me Nenin 7 të Ligjit për Prokurim Publik, ku thuhet: Autoriteti Kontraktues do t'i trajtojë operatorët ekonomikë në

mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Autoriteti Kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën midis operatorëve ekonomikë ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomikë. Mbi këtë, në mënyrë të qartë dhe decidive flet edhe dispozita ligjore në Nenin 4, Paragrafi 3, Nën-paragrafi c (4.3.C) i RRPP 001/2022, e cila thotë: Drejtësia/Mosdiskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit, pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatorin Ekonomik ose Operatorin Ekonomik potencial. Të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial." Mbarim citati.

Ndërsa, arsyetimi i Autoritetit Kontraktues për këtë pretendim ankimor të OE-së tonë, është si në vijim:

Citat *"Autoriteti Kontraktues - Ministria e Punëve të Brendshme - Divizioni i Prokurimit, në bashkëpunim me Njësinë Kërkuese, ka analizuar pretendimin tuaj dhe sqaron/konstaton se: profilet e kërkuara janë në harmoni të plotë me Aktivitetin e prokurimit dhe Nenin 69 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP). Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë nga operatorët ekonomikë të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës, pika 4.1., kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve. Nuk qëndron fakti që ka favorizim apo diskriminim, pasi që janë përfshirë profile të domosdoshme për realizimin e projektit dhe janë përfshirë disa profile ekuivalente, siç janë të cekura në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit. Mbështetur në këto shtjellime, ky pretendim ankimor nuk qëndron dhe refuzohet si I pabazuar."* Mbarim citati

Lidhur me të lartpërmendurën, AK as nuk e ka marrë mundin që të i shqyrtoj në tërësi dhe meritorisht pretendimet tona.

Pretendimi ynë ankimor ka qenë i diversifikuar në dy pika, dhe atë si në vijim:

a) Emërtimi i drejtimeve, duke pamundësuar drejtime tjera ekuivalente AK, është ndalur vetëm në këtë pikë, duke u munduar që në mënyrë lajthitëse të inkuadroj edhe fjalën "ekuivalente", e cila nuk gjendet në FTD të dosjes së tenderit. Duke marrë parasyshë faktin se për teknologji informative ekzistojnë më shumë se 50 drejtime Disa nga drejtimet ekuivalente, po i citojmë këtu: Inxhinier i diplomuar i elektroteknikës, Inxhinier Elektroteknike Drejtimi Kompjutera, Informatike Ekonomik, Informatikan, Informatikë Inxhinerike, Shkenca Kompjuterike dhe Teknologji Informative e Aplikuar, Inxhinieri Softuerike etj, ne kemi kërkuar që të mundohen drejtime ekuivalente ashtu që të mos reduktohet konkurrenca në mes të operatorëve ekonomik, e që është në kundërshtim me Nenin 7 të LPP-së, dhe me nenin 4.3.C të RRPP 001/2022.

b) Përvoja e punës së stafit

Autoriteti kontraktues nuk e ka trajtuar fare këtë kërkesë. Ky veprim i AK-së bie me automatizëm në kundërshtim nenin 108/A të LPP-së.

Në këtë drejtim, kërkojmë nga OSHP që të eliminohen shkeljet e kundërligjshme nga AK të dispozitave ligjore të nenit 7 të LPP-së dhe të nenit 4.3.C të RRPP-së, dhe të Opinionit Ligjor të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (nr. 1731/23, dt. 19/09/2023) ashtu që:

- TË MUNDËSOHEN DREJTIME EKUIVALENTE PËR TË GJITHA POZITAT

- TË LARGOHET KËRKESA QË MENAXHERI I PROJEKTIT "TË KETË

MENAXHUAR TË PAKTËN NJË (1) PROJEKT TË NGJASHËM SIPAS

KËRKESAVE TË PROJEKTIT" – në Opinionin Ligjor të Agjencisë për Parandalimin

e Korrupsionit nr. 1731/23, dt. 19/09/2023, thuhet se,

Citat

"*E rëndësishme për autoritetin kontraktues është që të vërtetoj se operatorët ekonomikë kanë kryer projekte në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, e jo si në rastin konkret ku është kërkuar numër I projekteve të menaxhuara për menxherin e projektit, sepse kërkesa e tillë mund ta kufizojnë konkurrencën e lirë dhe diskriminojnë operatorët ekonomikë të cilët kanë kapacitet të kënaqshëm ekonomik, teknik dhe profesional.*"

Mbarim Citati

Provë: Vendimi i datës 30/08/2024

Neni 108/A i LPP-së

2. Pretendimi ankimor i dytë (2) në Kërkesën tonë për Rishqyrtim, ishte ky si në vijim:

Citat

Autoriteti Kontraktues, me disa kërkesa në Aneks 1 të padefinuara qartë, ka shkelur Nenin 28 të Ligjit për Prokurim Publik, duke vendosur kërkesa që janë të pamatshme dhe të padefinuara qartë, siç parashikohet në këtë nen *a) Në faqe 21 keni parashtruar kërkesën "OE duhet të ofrojë mirëmbajtje dhe përkrahje të vazhdueshme në lidhje me funksionalitetin e sistemit dhe përdorimin e tij nga ana e shfrytëzuesve. Përkrahja duhet të jetë gjatë gjithë orarit zyrtar të punës dhe në raste të caktuara edhe pas orarit të tij ose ditëve të pushimit, për 36 muaj". Sipas përgjigjeve në pyetje dhe tabelës së çmimeve, mirëmbajtja do të jetë 30 muaj; andaj, ju lutemi ta korrigjoni këtë kërkesë.*

b) Në faqen 22 keni parashtruar kërkesën që "OE duhet të ofrojë diagramet e përdorimit të sistemit (use cases) dhe t'i konfirmojë ato me AK. Me qëllim që gjatë vlerësimit të ofertave të

mos ketë hapësira për interpretime ose keqinterpretime sipas dëshirave (interesave), ju lutemi ta specifikoni nëse kjo kërkesë duhet të realizohet pas kontraktimit të operatorit (gjatë implementimit) dhe jo gjatë ofertimit! Duke marrë parasysh që në fazën e dorëzimit të ofertave kërkesat nuk janë të detajuara dhe pas kontraktimit duhet të mbahet faza e intervistave, kjo kërkesë mund të realizohet vetëm pas kontraktimit të operatorit. Bazuar në atë që u tha më sipër, ju lutem të përmirësoni dosjen duke specifikuar qartë kur duhet të ofrohen këto dokumente (gjatë ofertimit apo gjatë implementimit). Nëse diagramet e përdorimit të sistemit (use cases) duhet të dorëzohen gjatë fazës së ofertimit, kjo kërkesë përbën favorizim të një OE që posedon informata jo zyrtare (më të detajuara se ato në dosje) dhe redukton konkurrencën.

c) Në faqe 23, në "5.3.5. Trajnimi dhe Dokumentimi", kërkohet ofrimi i shumë dokumenteve. Me qëllim që gjatë vlerësimit të ofertave të mos ketë hapësira për interpretime ose keqinterpretime sipas dëshirave (interesave), ju lutemi ta specifikoni që kjo kërkesë duhet të realizohet pas kontraktimit të operatorit (gjatë implementimit) dhe jo gjatë dorëzimit të ofertës!

d) Në faqe 21 keni parashtruar kërkesën "OE duhet të ofrojë një zyrtar (zhvillues) që dotë përkrahë sistemin gjatë orarit të punës dhe gjatë vikendit nëse kërkohet." Kujt duhet t'I ofrohet ky zyrtar, për çfarë periudhe, në cilën fazë, a duhet të jetë në zyrat e AK-së apo të OE-së, etj.? Ju lutem, definojeni qartë kërkesën ose largojeni atë, pasi kjo kërkesë, me këtë përshkrim, është e pamatshme dhe mund të ndikojë drejtpërdrejt në përpilimin e çmimit.

e) Në faqe 21 keni parashtruar kërkesën "Pajtueshmëria me Infrastrukturën Ekzistuese:

Platforma duhet të integrohet pa probleme me sistemet ekzistuese të IRK-ve." Kush do t'I krijojë parakushtet për integrim me sistemet ekzistuese të IRK-ve? Çfarë do të ndodhë nëse palët e tjera nuk plotësojnë parakushtet për integrim?

Mbarim citati

Ndërsa, arsyetimi i Autoritetit Kontraktues për këtë pretendim ankimor të OE-së tonë, është si në vijim:

Citat

Autoriteti Kontraktuese -Ministria e Punëve të Brendshme-Divizioni i Prokurimit në bashkëpunim me Njësinë Kërkuese ka analizuar pretendimin tuaj dhe sqaron/konstaton së: të gjitha specifikat janë në hamani me Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi I LPP-së Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale i LPP-se, Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata I posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës pika 4.1. kualifikimet shkollore dite profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve; Nenit 28 dhe 29 të LPP-së dhe Rregullore Nr.001/2022 për

Prokurimin Publik Neni 19 Specifikimet Teknike dhe nevojat e Autoritetit kontraktuese kjo nuk mund të vendoset nga OE-të së cilat janë nevojat e AK-së.

Pjesa kryesore e zhvillimit parashihet të bëhet në periudhën 6 mujore. Kurse gjatë periudhës së mbetur do të ketë avancime dhe përditësime në bazë të kërkesave të AK-së. Sipas përgjigjeve në pyetje të datës 27.08.2024 është sqaruar dhe tabelës së çmimeve, mirëmbajtja do të jetë 30 muaj ndërsa 6 muaj janë zhvillim dhe ne ketë pik nuk ka asnjë paqartësi Mbështetur nga shtjellimet e lartpërmendura ky pretendim ankimor nuk qëndron dhe refuzohet i pa bazuar.

Mbarim citati

Pra, lidhur me këtë pretendimin tonë, AK as nuk ka marrë mundimin që ta shqyrtoj të njëjtin. AK ka "shqyrtuar" vetëm pikën A të pretendimit, ndërsa në pikat tjera nuk është lëshuar fare, ku rrjedhimisht ka realizuar shkelje flagrante të dispozitave ligjore të nenit 108/A të LPP-së.

Në këtë drejtim, kërkojmë nga OSHP që:

- TA OBLIGOJ AK-në që pikat e lartcekura (te cilat nuk i ka trajtuar ne kerkese per rishqyrtim) të DEFINOHEN QARTË në mënyrë që gjatë vlerësimit të ofertave të mos ketë hapësira për interpretime ose keqinterpretime sipas dëshirave (interesave).

3. Për më tepër, AK në mënyrë flagrante dhe arbitrare shkelë dispozitat ligjore të nenit 109 të LPP ashtu që nuk ka bërë zgjatjen e dorëzimit të ofertave edhe për 10 ditë pas Vendimit në Kërkesën tonë për Rishqyrtim.

Nga sa më sipër, kërkojmë nga OSHP që të detyroj AK që

1. TA OBLIGOJ AK QË TA KORRIGJOJ DOSJEN ashtu që:

a) Mundësoj drejtime ekuivalente.

b) Të largoj përvojën e punës për punë specifike

c) Të rregulloj kërkesat në Aneksin 1 në mënyrë që të jenë të definuara qartë dhe të matshme.

<u>Përgjigje në pretendimet ankimore</u>

<u>Sqarim hyrës:</u>

Parashtruesi i ankesës – (OE) "LOGISTICS PLUS"L.L.C. (më tej OE ankues) ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 28.08.2024, për të cilën AK me datë 30.08.2024 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. Eksperti shqyrtues dhe teknik kanë shqyrtuar pretendimet ankimore të paraqitura që lidhen me shkeljen e dispozitave të LPP dhe RrPP. Ndërsa pretendimet ankimore në lidhje me opinionet e institucioneve tjera janë jashtë

autorizimeve të Ekspertëve.

Pretendimi ankimor 1

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe RrPP duke vendosur kritere që reduktojnë konkurrencën dhe për ankuesin janë diskriminuese.

Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 1

AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, tek kërkesat për kapacitetin teknike dhe profesional, ndër të tjera ka vendosur kërkesën: "*1.Menaxheri i projektit duhet të jetë inxhinier i diplomuar i shkencave kompjuterike ose Master i inxhinierisë ose shkencave kompjuterike, menaxhment informatike ose biznes dhe menaxhment dhe duhet te kete se paku njërën nga këto certifikatat PMP, PMI, ITIL, ScrumMaster, CAPM, IPMA, PRINCE2, CPM – dhe te ketë min. 5 vite përvojë pune dhe të ketë menaxhuar të paktën një (1) projekte të ngjashme sipas kërkesave të projektit.*". Lidhur me këtë kërkesë, dëshmitë dokumentare të kërkuara janë: "*1. Diploma përkatëse, CV, Certifikat perkatese kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi - (origjinal) Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit– (kopje), Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara.*"

OE ankues të njëjtin pretendim ankimor e kishte paraqitur edhe në kërkesën për rishqyrtim.

AK në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, lidhur me këtë pretendim ankimor kishte dhënë arsyetimin si vijon: "*Autoriteti Kontraktues - Ministria e Punëve të Brendshme - Divizioni i Prokurimit, në bashkëpunim me Njësinë Kërkuese, ka analizuar pretendimin tuaj dhe sqaron/konstaton se: profilet e kërkuara janë në harmoni të plotë me Aktivitetin e prokurimit dhe Nenin 69 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP). Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë nga operatorët ekonomikë të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës, pika 4.1., kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve. Nuk qëndron fakti që ka favorizim apo diskriminim, pasi që janë përfshirë profile të domosdoshme për realizimin e projektit dhe janë përfshirë disa profile ekuivalente, siç janë të cekura në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit. Mbështetur në këto shtjellime, ky pretendim ankimor nuk qëndron dhe refuzohet si i pabazuar.".*

Mendimi i ekspertit teknik lidhur me pretendimin ankimor 1

Eksperti sqaron se lidhur me kërkesën për kualifikim universitar, për menaxher të projektit, AK ka përcaktuar kualifikimin në inxhinieri ose shkenca kompjuterike, menaxhment informatikë, dhe biznes dhe menaxhment. Ankuesi, pretendon se nuk janë lejuar edhe

kualifikimet ekuivalente që sipas ankuesit janë me shumë se 50 drejtime, por duke përmendur vetëm disa drejtime (Inxhinier i diplomuar i elektroteknikës, Inxhinier Elektroteknike Drejtimi Kompjutera, Inforamtikë Ekonomik, Informatikan, Informatikë Inxhinerike, Shkenca Kompjuterike dhe Teknologji Informative e Aplikuar, Inxhinieri Softuerike etj,). Andaj, eksperti sqaron se lidhur me drejtimet e studimeve është evidente që AK ka dhënë disa opsione dhe nuk mund të pretendohet për favorizim të një OE, duke qenë se ka me qindra persona të kualifikuar në këto drejtime. Megjithatë, marrë parasysh që për AK-në janë të pranueshme edhe drejtimet menaxhment dhe biznes, atëherë edhe drejtimi i elektroteknikës është relevant dhe duhet të përfshihet në kërkesë duke marrë për bazë substancën e këtij aktiviteti të prokurimit. Më tej, lidhur me çështjen e përvojës kërkesa e AK përbën dy elemente, ku kërkohet përvojë në projekte të ngjashme dhe me tej saktësohet sipas kërkesave të projektit. Në lidhje me këtë kërkesë dhe formulim, eksperti sqaron se sipas rregullatives për prokurim publik, AK përcakton kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional përfshirë personelin për tu siguruar që OE ka kapacitetin e mjaftueshëm për realizimin e një aktiviteti, megjithatë formulimi i tillë i përvojës së ngjashme sipas kërkesave të përcaktuar nga AK në dosjen e tenderit, pa përmendur elemente të veçanta nuk mund të shërbejë si arsye e eliminimit nëse ankuesi apo ofertues tjerë kanë staf që ka përvojë në projekte të ngjashme por jo detyrimisht me kërkesat e dosjes së tenderit si në këtë aktivitet. Andaj, sipas sqarimeve të mësipërme, pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar, marrë për bazë faktin që AK duhet të përfshijë edhe drejtimin e elektroteknikës në kërkesës për kualifikimin universitar për menaxherin e projektit.

<u>Pretendimi ankimor 2</u>

OE ankues pretendon se AK ka përcaktuar kërkesa të padefinuara qartë në dosjen e tenderit.

<u>Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 2</u>

AK në dosjen e tenderit, përkatësisht në Aneksin 1 të dosjes së tenderit ka paraqitur ndër të tjera kërkesat në vijim për të cilat OE ankues pretendon se janë formuluar në kundërshtim me rregullativen për prokurim publik:

OE duhet të ofrojë mirëmbajtje dhe përkrahje të vazhdueshme në lidhje me funksionalitetin e sistemit dhe përdorimin e tij nga ana e shfrytëzuesve. Përkrahja duhet të jetë gjatë gjithë orarit zyrtar të punës dhe në raste të caktuara edhe pas orarit të tij ose ditëve të pushimit, për 36 muaj". Ndërsa në formularin e çmimit, në pozicionin 2-Mirembajtja dhe përditësimi i sistemit e-Kabineti, është përcaktuar kohëzgjatja 30 muaj.

OE duhet të ofrojë diagramet e përdorimit të sistemit (use cases) dhe t'i konfirmojë ato me AK.

Sigurimi i trajnimeve të duhura për përdoruesit fundor dhe krijimi i dokumentacionit të hollësishëm dhe të qartë për përdorimin e platformës.

OE duhet të dorëzoj manualin e përdorimit/integrimit të zgjidhjes të përditësuar sipas kërkesës së ASHI-së.

OE duhet të dorëzoj manualin e detajeve teknike (hostimit dhe publikimit) dhe të administrimit të aplikacionit dhe data bazës;

OE duhet të dorëzoj materialin e trajnimit i përdorur gjatë trajnimit të stafit;

OE duhet të dorëzoj video manualin e përdorimit dhe administrimit të sistemit sipas roleve.

OE duhet të dorëzoj manualin e detajeve teknike (instalimit, konfigurimit) dhe të administrimit (vetëm në formë elektronike)

OE duhet të dorëzoj kodet burimore (në formë elektronike) dhe përmes platfomave për versionizim të kodeve (Git repository, TFS, etj.)

OE duhet të mbajë trajnime adekuate për zyrtarë për përdorim të sistemit e-Kabinetid)

OE duhet të ofrojë një zyrtar (zhvillues) që do të përkrahë sistemin gjatë orarit të punës dhe gjatë vikendit nëse kërkohet.

Pajtueshmëria me Infrastrukturën Ekzistuese: Platforma duhet të integrohet pa probleme me sistemet ekzistuese të IRK-ve."

OE ankues të njëjtin pretendim ankimor e kishte paraqitur edhe në kërkesën për rishqyrtim.

AK në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, lidhur me këtë pretendim ankimor kishte dhënë arsyetimin si vijon: *Autoriteti Kontraktuese -Ministria e Punëve të Brendshme-Divizioni i Prokurimit në bashkëpunim me Njësinë Kërkuese ka analizuar pretendimin tuaj dhe sqaron/konstaton së: të gjitha specifikat janë në hamani me Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi I LPP-së Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale i LPP-se, Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata I posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës pika 4.1. kualifikimet shkollore dite profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve; Nenit 28 dhe 29 të LPP-së dhe Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik Neni 19 Specifikimet Teknike dhe nevojat e Autoritetit kontraktuese kjo nuk mund të vendoset nga OE-të së cilat janë nevojat e AK-së. Pjesa kryesore e zhvillimit parashihet të bëhet në periudhën 6 mujore. Kurse gjatë periudhës së mbetur do të ketë avancime dhe përditësime në bazë të kërkesave të AK-së. Sipas përgjigjeve në pyetje të datës 27.08.2024 është sqaruar dhe tabelës së çmimeve, mirëmbajtja do të jetë 30 muaj ndërsa 6 muaj janë zhvillim dhe ne ketë pikë nuk ka asnjë paqartësi Mbështetur nga shtjellimet e lartpërmendura ky pretendim ankimor nuk qëndron dhe refuzohet i pa bazuar.*

<u>Mendimi i ekspertit teknik lidhur me pretendimin ankimor 2</u>

Në lidhje me kërkesat e dosjes së tenderi, për të cilat ankuesi pretendon se janë të paqarta dhe konfuze eksperti sqaron si në vijim:

Lidhur me kërkesat për mirëmbajtje, në dosjen e tenderit, përkatësisht në aneksin 1, kërkesa ku OE precizon afatin 36 muaj për mirëmbajtje që nënkuptohet pas përfundimit të zhvillimit, përderisa në formularin e çmimit, pozicioni për vendosjen e çmimit është përcaktuar kohëzgjatja 30 muaj. Rrjedhimisht, është i paqëndrueshëm arsyetimi i AK-së në vendimin për refuzimin kërkesës për rishqyrtim ku thuhet se periudha prej 36 muaj përfshinë zhvillimin dhe mirëmbajtjen, për faktin se mirëmbajtja si proces fillon pas përfundimit të zhvillimit dhe pranimit.

Lidhur me kërkesën për diagramet e përdorimit, kërkesa është e qartë që të njëjtat duhet të dorëzohen para fillimit të implementimit dhe zhvillimin e sistemit nga OE i shpërblyer me kontratë, rrjedhimisht nuk ka dilemë se a duhet të njëjtat të dorëzohen me ofertë.

Edhe në këtë pikë, kërkesa është e qartë që dokumentet duhet të dorëzohen në fazën pas implementimit/zhvillimit dhe jo gjatë ofertimit.

Më tej, lidhur me pikën ku kërkohet "një zyrtar (zhvillues) që do të përkrahë sistemin gjatë orarit të punës dhe gjatë vikendit nëse kërkohet", ankuesi pretendon se është e paqartë për periudhën. Megjithatë, kërkesa është e qartë dhe e kuptueshme që ka të bëjë me periudhën e mirëmbajtjes.

Në fund, lidhur me kërkesën për pajtueshmëri me infrastrukturën ekzistuese, kërkesa është e përgjithësuar dhe nuk ofron një pasqyrë të qartë të punës që OE i përzgjedhur duhet të bëjë për të përmbushur këtë pikë. Përkatësisht AK do të duhej të listojë se cilat aspekte apo sisteme duhet të ndërlidhet dhe cilat janë funksionet/detyrat teknike që janë përgjegjësi e OE që duhet të përmbush në mënyrë që të realizohet kërkesa.

Si përfundim, sipas shtjellimeve të mësipërme eksperti sqaron se pretendimi është pjesërisht i bazuar. Përkatësisht në pikën për periudhën e mirëmbajtjes, AK duhet të harmonizojë periudhën e deklaruar në aneksin 1 të dosjes së tenderit me periudhën e përcaktuar në formularin e çmimit (paramasën). Gjithashtu, në pikën për pajtueshmëri me infrastrukturën ekzistuese, AK duhet të qartësojë se me cilat sisteme ndërlidhet dhe cilat janë përgjegjësitë e ofertuesve në këtë pikë.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti teknik dhe eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **"LOGISTICS PLUS"L.L.C.**

Ardian Behra

Kreshnik Spahiu